REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 40, datë 23.07.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "RIKONSTRUKSION ME SHTIM VOLUMI (SHTESË 1 KAT NË OBJEKTIN EKZISTUES 4 KAT)", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË DURRËS

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Z. Elton Hoxhaj, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Rikonstruksion me shtim volumi (shtesë 1 kat në objektin ekzistues 4 kat)", me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me subjekt zhvillues Z. Elton Hoxhaj.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 13/04/ 2026